



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 37 Akti

Nr. 61 Vendimi

Tiranë, më 02.08.2018

V E N D I M

Trupi gjyqësor i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Roland Ilija	Relator
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar znj. Elka Ermenkova, në Tiranë, më datë 31 korrik 2018, ora 15:15, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Gentjan Osmani**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e tij në seancë dëgjimore publike vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Gentjan Osmani, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, duke qenë kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (referuar më poshtë “Komisioni”).

3. Subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, në periudhën tetor 2004 - tetor 2013 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga tetori 2013 deri në prill 2015 ai ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Ndërsa nga maji 2015 e në vazhdim, z. Osmani ka qenë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

4. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka hedhur shortin në datën 30.11.2017, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Roland Ilia dhe Firdes Shuli. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia. Me vendimin nr. 29, datë 23.05.2018, Komisioni ka vendosur që komisionerja Alma Faskaj të zëvendësohet nga komisionerja Pamela Qirko.

5. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën me nr. ***, datë 13.11.2017.

6. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me

qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017, të deklasifikuar me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 08.01.2018, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

7. Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 04.01.2018.

8. Menjëherë me hedhjen e shortit, trupi gjykues administroi:

- raportin e vlerësimit të pasurisë sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (më poshtë referuar si “ILDKPKI”),
- raportin e vlerësimit të figurës sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (më poshtë referuar si “DSIK”),
- raportin e vlerësimit profesional sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

9. Me vendimin nr. 2, datë 16.07.2018, trupi gjykues vendosi:

- Të përfundojë hetimin paraprak në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Osmani.
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se provat e grumbulluara lidhur me vlerësimin e pasurisë kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, dhe atij i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, duke i vënë në dispozicion rezultatet paraprake të hetimit, në bazë të paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative.
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi deklarinimin e konfliktit të interesit, të drejtën për t’u njohur me dosjen, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitareve, si dhe afatin 9-ditor brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

10. Në datën 23.07.2018, subjekti i rivlerësimit njoftoi në rrugë elektronike dhe vuri në dispozicion të Komisionit pretendimet e tij, si dhe dokumentet shkresore, të cilat u administruan nga ana e trupit gjykues.

11. Me vendimin nr. 3, datë 27.07.2018, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 31.07.2018, ora 15:15, pranë Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati i 2-të, Tiranë.

12. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”*, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, duke u bazuar në të tria kriteret.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht më datë 27.07.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 31.07.2018, ora 15:15, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht. Ai parashtroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Gentjan Osmani ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar Vendimit nr. 2/2017^[1]

[1] *“41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat*

të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Në përputhje me nenin 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Z. Gentjan Osmani është bërë subjekt deklarues në vitin 2003. Në datën 25.01.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar “Vetting” pranë ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 32/1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- a) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin,*
- b) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pasuritë e subjektit është kryer proces i plotë hetimor administrativ nga Komisioni, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: deklaratimet e subjektit pranë ILDKPKI-së; provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raportin e dorëzuar pranë Komisionit; çdo dokument ligjor që përbën mjet prove sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; komunikimet me subjektin, si dhe

e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

sugjerime të vëzhguesit ndërkombëtar, për rrethana konkrete në procesin e vlerësimit të pasurisë.

Hetimi paraprak administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë, në evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive, deklarimeve të rreme apo konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 33, pika 5, e ligjit nr. 84/2016.

Procesi i rivlerësimit të pasurisë nga ana e Komisionit është bazuar në sa më poshtë:

Lidhur me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën “Vetting” nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur:

- ❖ **Apartament banimi**, me sip. 96 m², në “****”, kompleksi “****”, nr. pasurie ***, Tiranë. Në bashkëpronësi 50 % me bashkëshorten, fituar në bazë të kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***. rep., nr. *** kol., datë 13.01.2017, midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, si dhe bashkëshortes, znj. M. O., në vlerën 82.000 (tetëdhjetë e dy mijë) euro. Për këtë apartament, subjekti i rivlerësimit deklaroi shpenzime të arredimit të apartamentit të mësipërm në vlerën 3.000.000 (tre milionë) lekë, me burim kursimet e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes.

Burimi i krijimit:

- Shitja e pasurisë apartament 1+1 te “****”, me sipërfaqe të shfrytëzueshme 65 m², me nr. pasurie ***, në vlerën 80.000 (tetëdhjetë mijë) euro.
- 2.000 (dymijë) euro nga kursimet e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes në vite.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni:

1. Apartamenti është blerë më kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.01.2017, për shumën 82.000 euro. Kjo shumë është shlyer tërësisht nga subjekti i rivlerësimit me urdhër xhirimi pranë llogarisë në “Credins Bank” së noteres E.T.

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë¹ konfirmon se z. Gentjan Osmani, në bashkëpronësi me bashkëshorten e tij znj. M.N., kanë të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë apartament me sipërfaqe 96 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, zona kadastrale ***, Tiranë (pasuri aktive).

2. Si burim krijimi për këtë apartament, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e pasurisë apartament 1+1 te “****” me sipërfaqe të shfrytëzueshme 65 m², në

¹ Shih në dosje shkresën e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, nr. *** prot., datë 08.02.2008.

vlerën 80.000 (tetëdhjetë mijë) euro², pas rivlerësimit me aplikimin nr. ***, datë 13.10.2016, në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë³ vërteton se ky apartament ka qenë i regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të z. Gentjan Osmani në bashkëpronësi me znj. M.O. (pasuri e tjetërsuar).

Apartamenti është porositur me aktmarrëveshje datë 02.02.2009, me vlerë 67.680 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) euro. Bazuar në kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.09.2016, ky apartament shitet në vlerën 67.680 euro. Sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.10.2016, të shoqërisë ndërtimore “***” sh.p.k. u pagua vetëm 63.680 euro, pasi 4.000 euro u mbajtën si penalitet kontraktor për dorëzimin në vonesë të pasurisë. Bazuar në shkresën e shoqërisë “***” sh.p.k., shlyerja është kryer me mandatpagesa, përkatësisht:

- 15.000 euro, datë 31.01.2009;
- 32.680 euro, datë 21.03.2009;
- 5.000 euro, datë 16.01.2010;
- 3.000 euro, datë 28.05.2010;
- 4.000 euro, datë 25.06.2010;
- 4.000 euro, datë 02.07.2011.

Si burim krijimi për këtë apartament, subjekti i rivlerësimit deklaron:

a. Hua e shlyer tërësisht;

b. Dhurimi nga prindërit e bashkëshortes të shumës 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë lekë) pas martesës, për shkak të kontributit të saj në familje dhe porositjes së një apartamenti banimi.

Në lidhje me huan, rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave private të vitit 2009 ka deklaruar marrjen e huas në shumën 20.000 euro, me interes vjetor 5 %. Kjo hua është marrë me kontratë e datës 21.08.2009 nga shtetasit A.B.Q., i cili është djali i dajës së subjektit, dhe jeton e punon prej rreth 20 vitesh në Itali. Këtë hua ai e ka shlyer si më poshtë:

- në vitin 2011, shuma 7.000 euro;
- në vitin 2012, shuma 5.000 euro;
- në vitin 2013, shuma 8.000 euro.

Për sa u përket interesave, subjekti i rivlerësimit sqaron se, për shkak të marrëdhënieve të posaçme, ato janë shlyer pjesë-pjesë gjatë viteve 2009 - 2013, nga të ardhurat e deklaruara rregullisht dhe janë përfshirë në shpenzimet vjetore të familjes, duke qenë se nuk kanë qenë në vlerë të konsiderueshme. Për këto shlyerje nuk është lëshuar ndonjë dokument, për shkak të marrëdhënieve të posaçme familjare me subjektin.

² Shih në dosje kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2016, përpara noteres D.Ç.

³ Shih në dosje shkresën e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë nr. *** prot., datë 08.02.2008.

Nga ana e Komisionit, në zbatim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të dokumentonte burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. Q. Më datë 21.05.2018, subjekti i rivlerësimit deklaroi se djali i dajës së tij, z. A.Q., jeton dhe punon prej 20 vitesh në Itali. Ai ka punuar në ndërtim. Nga kontakti që ka pasur me të, ai i ka dërguar kopje të kontratave të punës nga viti 2002 deri në vitin 2009. Së bashku më përgjigjen, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur dokumentet e mëposhtme:

- i. kontratë, datë 15.07.2002;
- ii. kontratë, datë 16.02.2005;
- iii. certifikatë të të ardhurave të vitit 2006;
- iv. certifikatë të të ardhurave të vitit 2007;
- v. certifikatë të të ardhurave të vitit 2008.

Përveç dokumenteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit, pas dërgimit të barrës së provës në lidhje me aftësinë paguese të z. Q., ka bashkëlidhur edhe dokumentet e mëposhtme:

- i. Leje qëndrimi, lëshuar më datë 13.01.1999;
- ii. Fleta e parë e pasaportës italiane, me nr. ***;
- iii. Certifikata e të ardhurave CUD 2003 - për vitin 2002, ku duket që shuma e përfituar ka qenë në vlerën bruto 6.730,32 euro për 170 ditë pune;
- iv. Certifikata e të ardhurave CUD 2004 - për vitin 2003, ku duket që shuma e përfituar ka qenë në vlerën bruto 14.080,45 euro për 351 ditë pune;
- v. Certifikata e të ardhurave CUD 2005 - për vitin 2004, ku duket që shuma e përfituar ka qenë në vlerën bruto 16.605,85 euro për 365 ditë pune;
- vi. Certifikata e të ardhurave CUD 2006 - për vitin 2005, ku duket që shuma e përfituar ka qenë në vlerën bruto 14.957,86 euro për 331 ditë pune;
- vii. Certifikata e të ardhurave CUD 2007 - për vitin 2006, ku duket që shuma e përfituar ka qenë në vlerën bruto 17.679,99 euro për 365 ditë pune;
- viii. Certifikata e të ardhurave CUD 2008 - për vitin 2007, ku duket që shuma e përfituar ka qenë në vlerën bruto 18.503,04 euro për 365 ditë pune.
- ix. Certifikata e të ardhurave për vitin 2008, ku duket që shuma e përfituar ka qenë në vlerën bruto 11.495 euro.

- Në lidhje me aftësinë paguese të z. A.Q., trupi gjykues vlerëson se ai, që nga viti 1999 e në vijim, nuk ndodhet në Shqipëri, duke qëndruar në Itali. Në këtë shtet, ai ka realizuar të ardhura nga puna në shumën totale të 100.000 eurove. Në këto kushte, ai ka pasur mundësi për të kursyer shumën 20.000 euro, duke marrë në konsideratë dhe faktin se emigrantët nuk kanë një nivel të lartë jetese. Për sa më sipër, Komisioni krijon bindjen se z. A.Q. ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të kursyer shumën 20.000 euro.

Për sa i përket dhurimit nga prindërit e bashkëshortes të shumës 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë lekë) pas martesës, për shkak të kontributit të saj në familje dhe porositjes së një apartamenti banimi, është bërë analiza financiare si më poshtë:

Analizë financiare e familjes së bashkëshortes 2004 - 2008	
Të ardhura, bashkëshortja 2004 - 2008	3.788.682
Të ardhura, vjehri 2007 - 2008	438.969
TOTAL TË ARDHURA	4.227.651
Shpenzime jetese, 3 persona, 2004 - 2008	-1.754.196
Kursime të deklaruara	-550.000
TOTAL SHPENZIME + KURSIME	-2.304.196
Mundësia për kursime të tjera	1.923.455

- Siç shihet nga analiza financiare, rezultojnë se familja e bashkëshortes së subjektit ka pasur të ardhura të ligjshme për të dhuruar shumën 1.500.000 lekë.

Në lidhje me shlyerjen e kësteve të huas në shumën 20.000 euro, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka kryer analizën financiare, konkretisht: mbi shumën 7.000 euro të shlyer në vitin 2011; 5.000 euro në vitin 2012 dhe 8.000 euro në vitin 2013.

- a. Nga analiza financiare e vitit 2011, gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të mjaftueshme për shlyerjen e huas, kursimet e krijuara, si dhe shpenzimet e bëra gjatë vitit në shumën *-1.250.615 lekë*. Lidhur me këtë, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Në ushtrim të së drejtës ligjore për t'u mbrojtur, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratimet e tij bazuar në një parashtrim të titulluar "Qëndrime lidhur me rezultatet paraprake dhe dokumente shkresore"⁴, nga analizimi dhe verifikimi i të cilave, **në përfundim të hetimit administrativ, ka rezultuar e provuar se ai ka pasur të ardhura të mjaftueshme ligjore për të shlyer huan në këtë vit.**

Konkretisht, subjekti i rivlerësimit, sqaroi si më poshtë:

"Fillimisht në deklaratimet e tij dhe të bashkëshortes, kur është deklaruar fjala 'cash', është nënkuptuar fjala likuiditet/kursim në lek nga të ardhurat e vitit, qoftë brenda apo jashtë sistemit bankar. Për këtë arsye, shuma e deklaruar cash në deklaratimet e çdo viti nënkupton likuiditetet brenda dhe jashtë sistemit bankar. Si rrjedhojë, likuiditetet në banka nuk duhet t'i shtohen shumës së deklaruar, por janë pjesë e saj. Në këtë kohë, deri në shtator të vitit 2011 kam jetuar me prindërit, bashkëshorten me leje lindjeje dhe një fëmijë 20 muajsh. Shpenzimet kanë qenë më minimale se ato të llogaritura. Deri në shtator të vitit 2011, nuk kemi pasur shpenzime ujë, energji elektrike dhe konsum ditor familjar (ushqim, detergjent etj.), pasi janë përballuar nga prindërit e mi. Diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve brenda vitit nuk është -1.250.615 lekë, por + 5.897 lekë, e llogaritur si më poshtë:

⁴ Shih përgjigjet e subjektit nr. *** prot, datë 23.07.2018, në dosjen e Komisionit.

2.024.797 lekë (shuma e të ardhurave nga pagat e vitit 2011) - 1.186.292 lekë (shpenzime) -332.608 lekë (të ardhura të vitit për shlyerjen e këstit të huas) 500.000 lekë (kursime nga të ardhurat e vitit 2011).

Shuma prej 7.000 eurosh dhe 4.000 eurosh janë përballuar nga kursimet në vite në masën 517.392 lekë dhe të ardhurat gjatë vitit 2011 në masën 332.608, siç më lart shpjeguar. Shuma e kursyer nga të ardhurat vjetore nuk është 1.450.000 lekë, por, ashtu siç unë kam deklaruar në deklaratën e vitit 2011, kjo shumë është 500.000 lekë. Pasuria neto e vitit 2011 është 500.000 lekë likuiditete të disponuara për vitin tjetër nga të ardhurat e vitit 2011 + shuma 332.608 lekë (e harxhuar nga të ardhurat e vitit 2011 për shlyerjen e huas). Shlyerjet e huas gjithnjë janë bërë në fund të vitit, gjatë muajit dhjetor të çdo viti, pasi disponoja likuiditetet e nevojshme për këto shlyerje. Në total, gjendja e likuiditeteve më datë 31.12.2011 është në masën 850.000 lekë të mbetura nga likuiditetet e viteve të tjera + 500.000 lekë kursime të vitit 1.350.000 lekë. Përfundimisht, pasuria e mbartur për vitin 2012 apo deri më datë 31.12.2011 përbëhet nga likuiditete në masën 1.350.000 lekë.

Si rrjedhojë, tabela përfundimtare duhet të jetë:

VITI	TË ARDHURA	PASURI NETO	SHPENZIME	PASURI + SHPENZIME	TË ARDHURA – PASURI-SHPENZIME
2010	2.024.797 lekë	332.608 lekë + 500.000 lekë	1.186.292 lekë	2.018.900 lekë	+ 5.897 lekë”.

- b. Nga analiza financiare e vitit 2012** ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të mjaftueshme për shlyerjen e huas, kursimet e krijuara, si dhe shpenzimet e bëra gjatë vitit në shumën -112,169 lekë. Lidhur me këtë, subjektit i ka kaluar barra e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Në ushtrim të së drejtës ligjore për t’u mbrojtur, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratimet e tij bazuar në një parashtrim të titulluar “Qëndrime lidhur me rezultatet paraprake bazuar në dokumente shkresore”⁵, nga analizimi dhe verifikimi i të cilave, **në përfundim të hetimit administrativ, ka rezultuar e provuar se ai ka pasur të ardhura të mjaftueshme ligjore për të shlyer huan në këtë vit.**

Konkretisht subjekti i rivlerësimit sqaroi si më poshtë:

“Fillimisht në deklaratimet e mia dhe të bashkëshortes, kur është deklaruar fjala ‘cash’, është nënkuptuar fjala likuiditet/kursim në lek nga të ardhurat e vitit, qoftë brenda apo jashtë sistemit bankar. Për këtë arsye, shuma e deklaruar cash në deklaratimet e çdo viti nënkupton likuiditetet brenda dhe jashtë sistemit bankar. Si rrjedhojë, likuiditetet në banka nuk duhet t’i shtohen shumës së deklaruar, por janë pjesë e saj. Në këtë kohë kam qenë me një fëmijë 2 vjeç dhe 3 muajsh, lindur në shtator 2012, shpenzimet kane qenë minimale. Paga, sipas statement-it, është në vlerën totale 1.917.486 lekë dhe jo

⁵ Shih përgjigjet e subjektit nr. *** prot., datë 23.07.2018 në dosjen e Komisionit.

1.746.240 lekë. Diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve brenda vitit nuk është - 112.169, por + 2.911, e llogaritur si më poshtë:

1.917.486 lekë (shuma e të ardhurave nga pagat e vitit 2012) – 565.975 lekë (shpenzime) – 348.600 lekë (të ardhura të vitit për shlyerjen e këstit të huas) - 1.000.000 lekë (kursime nga të ardhurat e vitit 2012) = shuma prej 5.000 eurosh është përballuar nga të ardhurat në vite dhe të ardhurat gjatë vitit 2012 (në masën 346.600 lekë), siç më lart shpjeguar. Pra, shuma prej 5,000 eurosh, sipas raportit dhe asaj që del, është paguar nga të ardhurat e viteve të tjera në masën 350.000 lekë dhe nga të ardhurat e vitit 2012 në masën 348.600 lekë (350.000 + 348.600 = 698.600 lekë). Në çdo rast, lekët janë konvertuar në euro, duke shfrytëzuar kursin më të ulët të këtyre viteve.

Shuma e kursyer nga të ardhurat vjetore është 1.000.000 lekë. Pasuria neto e vitit 2011 është 1.000.000 lekë likuiditete të disponuara për vitin tjetër nga të ardhurat e vitit 2012 + shuma 348.600 lekë (e harxhuar nga të ardhurat e vitit 2012 për shlyerjen e huas). Shlyerjet e huas gjithnjë janë bërë në fund të vitit, gjatë muajit dhjetor të çdo viti, pasi disponoja likuiditetet e nevojshme për këto shlyerje. Në total, gjendja e likuiditeteve më datë 31.12.2012 është në masën 1.000.000 lekë të mbetura nga likuiditetet e viteve të tjera + 1.000.000 lekë kursime të vitit = 2.000.000 lekë.

Përfundimisht, pasuria e mbartur për vitin 2013 apo deri më datë 31.12.2012 përbëhet nga likuiditete në masën 2.000.000 lekë.

Si rrjedhojë, tabela përfundimtare duhet të jetë:

VITI	TË ARDHURA	PASURI NETO	SHPENZIME	PASURI+ SHPENZIME	TË ARDHURA PASURI-SHPENZIME
2012	1.917.486	348.600 lekë + 1.000.000 1.348.600	565.975 lekë	1.914.575	+ 2.911 "

- c. **Nga analiza financiare e vitit 2012** ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare për shlyerjen e huas, kursimet e krijuara, si dhe shpenzimet e bëra gjatë vitit në shumën - 1.136.135 lekë. Në ushtrim të së drejtës ligjore për t'u mbrojtur, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratimet e tij bazuar në një parashtrim të titulluar "Qëndrime lidhur me rezultatet paraprake bazuar në dokumente shkresore"⁶, nga analizimi dhe verifikimi i të cilave, **në përfundim të hetimit administrativ, ka rezultuar e provuar se ai ka pasur të ardhura të mjaftueshme ligjore për të shlyer huan në këtë vit.**

Konkretisht, subjekti i rivlerësimit, sqaroi si më poshtë:

"Fillimisht në deklaratimet e mia dhe të bashkëshortes, kur është deklaruar fjala 'cash', është nënkuptuar fjala likuiditet/kursim në lek nga të ardhurat e vitit, qoftë brenda apo jashtë sistemit bankar. Për këtë arsye, shuma e deklaruar cash në deklaratimet e çdo viti nënkupton likuiditetet brenda dhe jashtë sistemit bankar. Si rrjedhojë, likuiditetet në banka nuk duhet t'i shtohen shumës së deklaruar, por janë pjesë e saj.

⁶ Shih përgjigjet e subjektit nr. *** prot., datë 23.07.2018, në dosjen e Komisionit.

Në çdo rast lekët janë konvertuar në euro, duke shfrytëzuar kursin më të ulët të këtyre viteve.

Diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve brenda vitit nuk është -1.136.135 lekë, por + 40.212 lekë, e llogaritur si më poshtë:

2.133.069 lekë (shuma e të ardhurave nga pagat e vitit 2013) - 642.857 lekë (shpenzime) -1.450.000 lekë (kursime nga të ardhurat e vitit 2013).

Shuma prej 8,000 eurosh, bazuar në të dhënat e raportit dhe të akteve të tjera, duhet të jetë paguar nga të ardhurat e viteve të tjera, $2.000.000 - 1.121.680 = 878.320$ lekë të mbetura për vitin tjetër. Shuma e kursyer nga të ardhurat vjetore del qartë se është 1.450.000 lekë, aq sa është deklaruar rregullisht. Pasuria neto e vitit 2013 është 1.450.000 lekë likuiditete të disponuara për vitin tjetër nga të ardhurat e vitit 2013.

Shlyerjet e huas gjithnjë janë bërë në fund të vitit, gjatë muajit dhjetor të çdo viti, pasi disponoja likuiditetet e nevojshme për këto shlyerje, duke i kthyer ato me kursin më të favorshëm. Në total, gjendja e likuiditeteve më datë 31.12.2013 është në masën 1.450.000 lekë të mbetura nga likuiditetet e viteve të tjera + 878.320 lekë kursime të vitit = 2.328.320 lekë. Përfundimisht, pasuria e mbartur për vitin 2014 apo deri më datë 31.12.2013, përbëhet nga likuiditete në masën 2.328.320 lekë.

Përfundimisht, tabela përfundimtare duhet të jetë:

VITI	TË ARDHURA	PASURI NETO	SHPENZIME	PASURI+ SHPENZIME	TË ARDHURA- PASURI- SHPENZIME
2013	2.133.069 lekë	1.450.000 lekë	642.857 lekë	2.092.857 lekë	+ 40 212 "

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për të shlyer huan në shumën 20.000 euro.

Nga ana e Komisionit është kryer dhe një analizë financiare në lidhje me shlyerjen e kësteve të këtij apartamenti, nga ku ka rezultuar se:

a. Gjatë vitit 2009, subjekti ka paguar dy këste, përkatësisht 15.000 euro më datë 31.01.2009 dhe 32.680 euro më datë 21.03.2009. Pra, në total **deri më datë 21.03.2009** janë paguar 47.680 euro (6.579.840 lekë). Gjatë analizës financiare u morën në konsideratë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij **deri më këtë datë.**

b. **Nga analiza financiare** rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh financiare në shumën 1.043.092 lekë, për likuidimin e dy kësteve të apartamentit.

Subjekti i rivlerësimi, pasi iu kalua barra e provës, sqaroi se:

"1. Mandati i arkëtimit me nr. ***, datë 21.03.2009, është prerë në mënyrë të njëanshme nga përfaqësuesit e shoqërisë "****" sh.p.k., me qëllim për ta ndihmuar, për të kryer pagesat në çdo kohë në arkë (arkëtimin e shumës), pa qenë e nevojshme prania e

përfaqësuesve të shoqërisë. Pra, mandati i arkëtimit në vlerën 32.680 euro, nuk është paguar i plotë më datë 21.03.2009, pasi nga ana e tij nuk disponoheshin likuiditete të mjaftueshme në euro për pagesën e plotë. Pagesa e plotë është bërë deri në muajin dhjetor 2009.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se në kontratën e lidhur më datë 02.02.2009 nuk parashikohet ndonjë shlyerje e detyrueshme brenda muajit mars 2009. Përkundrazi, në këtë kontratë parashikohet afati i shlyerjes së plotë të shumës deri në dhjetor të 2009. Gjithashtu, për të provuar pretendim të tij, subjekti ka depozituar edhe përgjigjen e shoqërisë "****" sh.p.k., e cila deklaron se: *“Bazuar në marrëdhëniet e mirëbesimit që ne kemi krijuar me njëri-tjetrin në lidhjen e kësaj aktmarrëveshjeje, pamundësinë fizike të subjektit të rivlerësimit për të qenë prezent gjatë orëve të punës së administratës, si dhe duke pasur në konsideratë parashikimet kontraktore të kontratës 02.02.2009, nga ana e shoqërisë është lejuar faturimi i shumës në mandatin e arkëtimit nr. ***, prej 32.680 eurosh (kësti më i madh), realisht kjo shumë është arkëtuar deri në fund të vitit 2009”.*

Bazuar në deklaratën e firmës “****” rezulton se pagesa për këtë apartament nuk është kryer në muajin mars të vitit 2009, por deri në fund të vitit 2009.

- Pas sqarimeve dhe provave të dërguara nga ana e subjektit të rivlerësimit, rezulton se ato janë bindëse dhe Komisioni në përfundim konkludon se ai ka pasur burime të mjaftueshëm për të shlyer këstet e këtij apartamenti.

❖ Në deklaratën e interesave private të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit deklaron një automjet tip “Golf 3” në vlerën 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë me kontratën e blerjes në datën 29.07.2005.

Lidhur me arsyet e mosdeklarimit të këtij automjeti në vitin 2005, subjekti, në pyetëtorin e datës 29.04.2018, deklaron ndër të tjera se është menduar si e deklaruar në vitin 2005, por që është konstatuar gjatë deklarimeve të interesave private të vitit 2009, në kohën kur ka bërë deklaratimet së bashku me bashkëshorten për pasuritë e disponuar veçmas.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit shprehet se burim i të ardhurave për blerjen e kësaj makine në vitin 2005 janë kursimet nga paga dhe shpërblimet në vite nga Shkolla e Magjistraturës dhe detyra si prokuror. Për sa i përket aktit të blerjes, nuk disponohet nga ana e tij, për shkak se i ka humbur. Edhe deklarimi i bërë në vitin 2009 është bërë duke u bazuar në mënyrë të përafërt. Çmimi i blerjes ka qenë rreth 2.000 - 2.100 euro dhe procedura e zhdoganimit të mjetit të paguar nga ana e tij ka kushtuar rreth 170.000 lekë. Ky automjet është targar për herë të parë në DRSHTR Tiranë, me targë ***, në vitin 2005. Automjeti ka qenë “Volkswagen” “Golf 3”, me vit prodhimi 1995, lloji i karburantit benzinë. Ky automjet është shitur me kontratën noteriale të shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 08.06.2010, kopje të së cilës subjekti i rivlerësimit e vë në dispozicion.

Për automjetin me targa *** iu kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor⁷, e cila dërgoi dosjen e automjetit.

- a. **Nga analiza financiare e kryer për këtë mjet**, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e makinës.

Nga ana e subjektit të rivlerësimit, pasi iu kalua barra e provës, u sqarua se:

“Automjet tip ‘Golf 3’, në vlerën 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë, fituar me kontratën e shitblerjes datë 29.07.2005, nuk është blerë me kursimet nga paga e vitit 2005, por nga likuiditetet që ai kishte nga kursimet e vitit 2004, pra nga shuma 750.000 lekë. Nga kjo shumë, kanë mbetur likuiditete nga të ardhurat e vitit 2004 në vlerën 750.000 - 450.000 - 300.000 lekë.

Likuiditetet e krijuara dhe të deklaruara në shumën 400.000 lekë për vitin 2005 u përkasin të ardhurave të vitit 2005, pra shumës 814.949 lekë, së cilës i janë zbritur shpenzimet për jetese dhe të tjera. Në tabelën tuaj përfundimtare kjo shumë është vendosur në mënyrë jo të saktë, në vlerën 1.150.000 lekë.

Përfundimisht, pasuria e mbartur për vitin 2006 apo deri më datë 31.12.2005, përbëhet nga:

- i. Likuiditete në masën 700.000 lekë.*
- ii. Pasuri e luajtshme (makinë) në vlerën 450.000 lekë.”*

- Pas sqarimeve të dërguara nga ana e subjektit të rivlerësimit rezulton se ato janë bindëse dhe Komisioni në përfundim konkludon se ai ka pasur burime të mjaftueshëm për të shlyer këstet e këtij apartamenti.

- ❖ **Në lidhje me automjetin e markës “Volkswagen”, tipi “Golf”, viti i prodhimit 2003, 50 % me bashkëshorten, blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.07.2015, çmimi 400.000 (katërqind mijë) lekë.** Burimi i krijimit janë kursimet e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes nga paga dhe shpërblime të tjera në vite.

- **Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit rezulton se subjekti i rivlerësimit i kishte të ardhurat për blerjen e këtij automjeti.**

- ❖ Apartament 3+1, sipërfaqe 106,90 m², rruga “****”, Tiranë, me nr. pasurie ***, bashkëpronësi me prindërit e tij dhe vëllain 25 %, blerë me kontratat e shitjes me shitës Entin Kombëtar i Banesave, datë 22.5.1998, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.09.1999, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.02.2003, kundrejt vlerës 1.415.548 lekë, me burim të ardhurat e familjes të asaj kohe.

⁷ Shih në dosje shkresën me nr. *** prot., datë 14.05.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, si dhe kthim-përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, nr. ***, datë 05.07.2018.

➤ **Komisioni, nga analiza e fakteve vëren se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë⁸.**

- ❖ Pasuri në përdorim të përkohshëm, autoveturë “Mercedes-Benz” 204, C200CDI, viti i prodhimit 2007, me targë ***, vlera 900.000 (nëntëqind mijë) nga subjekti B.K.

➤ **Komisioni, nga analiza e fakteve vëren se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar.**

- ❖ Subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, në deklaratën “Vetting” deklaroi llogari bankare dhe gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, si më poshtë:
 - Shuma 400.000 lekë në *cash*, jashtë sistemit bankar, për nevoja të familjes, 50 % me bashkëshorten, me **burim krijimi** kursimet e subjektit dhe të bashkëshortes.
 - Gjendja e llogarisë bankare në “Credins Bank”, me vlerë 20.060 (njëzetmijë e gjashtëdhjetë euro), 50 % me bashkëshorten.

Burimi i krijimit:

- Kursimet e subjektit dhe të bashkëshortes nga paga dhe shpërblime të tjera ndër vite.
- Llogari në “Intesa Sanpaolo Bank” 353.24 euro, nga trajnimi i bashkëshortes në “International Finance Corporation”, 50 % me bashkëshorten.

Burimi i krijimit:

- Kompensim nga një udhëtimi i bashkëshortes për një trajnim në programin e organizuar nga International Finance Corporation (IFC) “Eorld Bank Group” në Malajzi.
- **Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e tyre.**

Konkluzion përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/ 2016:

- Deklarimi në deklaratën “Vetting” është i saktë dhe në përputhje me ligjin. Pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet ndër vite nuk kanë sjellë pasoja të tilla që ato të konsiderohen të pamjaftueshme në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.**
- Nuk ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë.**
- Nuk është kryer fshehje pasurie.**
- Nuk ka deklarime të rreme.**
- Subjekti nuk ndodhet në situatën e konfliktit të interesit.**

⁸ Shih në dosje shkresën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë nr. ***, datë 08.02.2018.

B. MBLEDHJA E INFORMACIONEVE DHE PROVAVE MBI PASTËRTINË E FIGURËS SË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. ***, datë 27.10.2017, dhe të deklasifikuar me vendim të KDZH-së, nr. *** prot., datë 08.01.2018, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar: *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Osmani”*.

- *Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive për shkak të funksionit apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.*

C. MBLEDHJA E INFORMACIONEVE DHE PROVAVE MBI VLERËSIMIN E AFTËSIVE PROFESIONALE TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT, Z. GENTJAN OSMANI

Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor. Grupi i Punës ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 04.01.2018, përcjellë me shkresën e Prokurorit të Përgjithshëm, nr. *** prot., datë 04.01.2018.

Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme është bazuar në:

- 1) Formularin e vetëdeklarimit, 3 dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumente të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit.
- 2) 5 dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE

Subjekti rivlerësimit nuk rezulton të ketë të dhëna për masa disiplinore dhe ankesa në burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionit u bazua në gjetjet e këtij raporti, në shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku u konstatua:

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore të paraqitura prej tij dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ai analizon normën penale të zbatueshme, duke e lidhur përmbajtjen e saj me akte të tjera ligjore dhe nënligjore vendase dhe ndërkombëtare apo me praktikën gjyqësore, kryesisht atë të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese.

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se:

Për vitin 2014 - subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij.

Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij.

Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, ka aftësi në arsyetim ligjor. Në tekstet e akteve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurori. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyra drejtuese, si drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe zëvendësdrejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Për këtë shkak, ky subjekt nuk ka të dhëna statistikore në lidhje me ngarkesën e çështjeve që ka pasur për hetim, në të njëjtën masë si prokurorët e tjerë.

Konstatohet se prokurori Gentjan Osmani ka ushtruar ndjekje penale në hetim dhe përfaqësim në gjykim vetëm në disa raste, pasi për shkak të funksionit që ka kryer, ka qenë i angazhuar me një sërë detyrash të tjera.

Lidhur me efektivitetin në aspektet sasiore dhe kohore të prokurorit Gentjan Osmani, për shkak të detyrës që ai ka kryer, analiza e të dhënave të tij bëhet në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe KEDNj-së, akte këto të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Nga analiza e 5 çështjeve të përzgjedhura në short, rezultoi se vendimmarrjet e tij janë kryer brenda afateve të arsyeshme dhe në përputhje me standardet për një proces të rregullt. Nuk rezulton që ndonjë prej personave nën hetim, në kuadrin e këtyre procedimeve penale, të ketë pësuar ndonjë cenim të të drejtave dhe lirive të tij, për shkak të afatit të vendimmarrjes nga subjekti i rivlerësimit.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, është eficient dhe efektiv. Vendimet janë marrë brenda një afati të arsyeshëm, ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, duke kryer detyrat e ngarkuara me shpejtësi, pa dëmtuar ecurinë e çështjeve. Në këtë drejtim, duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, ka treguar aftësi në kryerjen e veprimeve procedurale hetimore. Ai, për shkak të funksionit si drejtues dhe zëvendësdrejtues, ka kryer edhe kontrollin e procedurave hetimore të kryera nga prokurorët në varësi të tij dhe Policia Gjyqësore.

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë organizative të treguara prej tij.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, në ushtrim të kompetencave të tij, ka aftësi për të administruar dosjet.

Në ushtrimin e rolit të tij si drejtues dhe zëvendësdrejtues, ka treguar aftësi për të evidentuar veprimet hetimore të nevojshme për t'u kryer, duke udhëzuar prokurorin për kryerjen e tyre nëpërmjet vendimmarrjes.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Nga verifikimi në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, rezultoi se për periudhën e vlerësimit, tetor 2013 - tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se është vlerësuar “shumë mirë” për etikën profesionale të treguara prej tij.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me ndikimin e tij ndaj çdo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Osmani. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në format letër dhe në dokumentet ligjore, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi me shkrim, në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Genjtan Osmani, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e komunikimit të treguara prej tij.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se tregohen aftësi të subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, për të bashkëpunuar me kolegët.

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit të treguara prej tij.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, ka marrë titullin “Jurist”, më datën 04.07.2001, në Universitetin e Tiranës, pas kryerjes së periudhës së studimeve 1997 - 2001. Në vijim ai ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, duke u diplomuar në profilin “Prokuror”, me titullin “Magjistrat”. Gjithashtu, ai ka paraqitur një tërësi dokumentesh që tregon pjesëmarrjen e tij aktive në trajnime të ndryshme.

Subjekti i rivlerësimit, z. Genjtan Osmani, i nënshtrohet programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Megjithatë, rezulton se është pjesë e këtij programi në cilësinë e ekspertit.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, bazuar në ankesat e subjekteve denoncues si më poshtë:

1. Në denoncimin e znj. A.N.
2. Në denoncimin e z. A.B.

Ankesa 1.

Me denoncimin nr. *** prot., datë 23.01.2018, znj. A.N. denoncon subjektin e rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, për zvarritje në proces, aftësitë profesionale, vendime në kundërshtim me ligjin.

Në denoncimin e saj, znj. A.N. ankohet për një çështje civile me objekt: “Padi trashëgimie”, e cila zvarritet me dashje nga ana e gjyqtarëve në bashkëpunim me prokurorët që nuk i hetojnë për arsye korruptive të dukshme. Denoncuesja shprehet se

janë kallëzuar penalisht nga Shoqata e Avokatëve Antikorrupsion të Shqipërisë disa gjyqtarë, por këta janë amnistuar nga ish-drejtuës i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, z. Gentjan Osmani.

Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur nga znj. A.N. nuk ka indice për të provuar pretendimin e denoncueses.

Ankesa 2.

Me denoncimin nr. *** prot., datë 25.01.2018, z. A.B. denoncon subjektin e rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, për aftësitë profesionale, korrupsion, shkelje të etikës profesionale.

Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur nga z. A.B. nuk ka indice për të provuar pretendimin e denoncuesit.

Pas shqyrtimit të raportit dhe denoncimeve në tërësi, nuk rezultuan fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, për pasojë nuk konstatohen indice apo elemente që mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojë figurën e prokurorit.

Për sa më sipër unë, Roland Ilia, në cilësinë e relatorit të çështjes, pasi hetova raportin e Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, nuk gjeta indice apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit dhe propozoj për subjektin e rivlerësimit, z. Gentjan Osmani: “I aftë”.

V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të lartë të vlerësimit të aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gentjan Osmani, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

Ky vendim të ankimohej pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 02.08.2018.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes Shuli
Kryesues

Pamela Qirko
Anëtar

Roland Ilia
Relator

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj